



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERNITA A. HAXHIU  
ADRESA KAJO KARAFILI,  
PALL. "MC INERIE"  
TEL:

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)


Nr. repertori: 277

Nr. koleksioni: 230

Tirane më 02/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023050660025593677



**KONTRATË SHITBLERJE**  
**KUOTASH KAPITALI**

Sot ne Tirane, me date 02/03/2023(dymijë e njezet e tre), ne Zyren e Noterise Tirane, para meje notere **Ernita Haxhiu**, me seline Tirane, Rr. "Kajo Karafili" u paraqiten palet si me poshte, te cilet me kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitje:

**I. PALËT**

**Pala Shitëse:** **Lorin Çekrezi**, shtetas shqiptar, i biri i Arben dhe Loreta, i datëlindjes 26/01/1989, lindur në Tirane dhe banues në adresën rruga Princ Vidi Pallati 1 shkalla 1 apartamenti 3 madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033089291 dhe numër personal I90126057L.

**Pala Blerëse:** **Klaudjo Cari**, shtetas shqiptar, i biri i Petraq dhe Marjana, i datëlindjes 14/10/1987, lindur në Tirane dhe banues në adresën rruga Besim Imami Nr 50, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037384565 dhe numër personal I71014034C.

**Kushtet Paraprake**

- Shoqëria "STUDIOARCH4" shpk, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) L52122135Q me zyrë qendrore në Tiranë, rruga Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Besim Imami, Ndertesa nr.34, kati pare perdhe; me kapital 7,518,408 (shtate milion e peseqind e tetembedhjete mije e katerqind e tete) lekë; me ortak z. Lorin Çekrezi, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 66.66 % të kapitalit të shoqërisë; z. Rezart Struga, zotërues i 1 (nje) kuote, e cila perben 33.34% te kapitalit te shoqerise; me administrator z. Lorin Çekrezi.
- Pala shitëse është e interesuar të shesë një pjesë të kuotës e cila përfaqëson 33.33% të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk;
- Palët paraprakisht kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse ne llogarine bankare te shitesit.

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

**II. OBJEKTI**

**2.1** Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Lorin Cekrezi, i shet palës blerëse z. Klaudjo Cari pjesen prej 33.33 %, e cila perben 33.33% te pjesës se plote te kuotave që zotëron në shoqërinë "STUDIOARCH4" shpk.. Për efekt të kësaj shitje kuota e zotëruar nga z. Cekrezi pjesëtohet sipas te dhenave siperpermendur dhe pas shitjen shoqëria do të ketë 3 kuota, një te zotëruar nga z. Lorin Çekrezi, e cila do të përbëjë 33.33 % të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk, njëra e zotëruar nga z. Rezart Struga e cila do të përbëjë 33.34 % të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk dhe njëra e zotëruar nga z. Klaudjo Cari e cila do të përbëjë 33.33 % të kapitalit te shoqerise.

**2.2** Pas regjistrimit të kësaj kontrate në QKB, ortakët e shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk, do të jenë:

- Z. Lorin Çekrezi, zotërues i 1 (nje) kuotave e cila përfaqëson 33.33 % të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk;
- Z. Rezart Struga, zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk.
- Z. Klaudjo Cari, zotërues i 1 (nje) kuotave e cila përfaqëson 33.33 % të kapitalit të shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk;

**III. ÇMIMI**



3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së pjesës së kuotës objekt i kësaj kontrate, është 21,825 (njezet e nje mije e teteqind e njezet e pese) euro. Kjo shume do te paguhet perkatesisht nga z. Klaudjo Cari i cili duhet te derdhe ne favor te z. Lorin Cekrezi 21,825 (njezet e nje mije e teteqind e njezet e pese) euro. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse brenda 24 oreve nga nenshkrimi i kontrates në llogarinë bankare nr: 0041017434, iban: AL75202110510000000041017434, llogari ne Raiffeisen bank, të komunikuar nga pala shitëse Lorin Cekrezi. Afati i percaktuar per te paguar shumat eshte jo me shume se 24 ore pas nenshkrimet te kontrates. Pjese bashkengjitur e kesaj kontrate do te jene mandati bankar ku duhet te jene shuma e sipermendur perkatesisht nga Klaudjo Cari.

3.2 Per rregjistrimin e kesaj kontrate ne QKB duhet te jete pjese mandati bankar i permendur ne piken 3.1. Ne rast te mungeses se mandatit bankar per shumen perkatese te bleresit te percaktuara ne piken 3.1, drejt llogarise bankare te shitesit te percaktuar ne piken 3.1, kontrata eshte e pavlefshme, e per rrjedhoje nuk mund te behet rregjistrimi ne QKB. Kontrata eshte e pavlefshme edhe ne rast se ne mandatet bankare nuk plotesohen shumat e plota te permendura ne piken 3.1

3.3 Ne rast se shuma e dakortesuar per tu derdhur nga pala blerese ne llogarine e pales shitese nuk kane zbatuar afatin prej 24 oresh nga nenshkrimi i kontrates, i percaktuar edhe ne piken 3.1, kontrata nuk do te jete e vlefshme

#### **IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE**

4.1 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate. Nëse nuk plotësohet ky afat, kontrata konsiderohet e pavlefshme.

4.2 Pala shitëse ka te drejten e pronësise intelektuale mbi te gjitha materialet, projektet, vizatimet, maketet, vizatimet teknike, imazhet qe jane prodhuar nga themelimi i kompanise deri ne momentin e nenshkrimet te kontrates. Mund ti perdor ato lirisht me kushtin qe te citohet bashkepronësia intelektuale me Studioarch4 apo pale te treta kur keto ekzistojne, pamvaresisht ku keto materiale shfaqen, ne forme dixhitale ose jo, ne web, rrjete sociale, cmime arkitekture etj.

#### **V. KALIMI I PRONËSISË**

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkimit të saj dhe bashkëngjitur mandatet bankare te pagesave te shumave te percaktuara ne kete kontrate brenda afatit te percaktuar ne kete kontrate. Lorin Çekrezi, Z.Klaudjo Cari dhe z. Rezart Struga behen ortaket e shoqërisë "STUDIOARCH4" shpk, duke zotëruar perkatesisht 33.33 % , 33.33% dhe 33.34 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) njesi origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

**PALA SHITËSE**

**LORIN ÇEKREZI**

Lorin Cekrezi

**NOTERE  
ERNITA HAXHIU**

**PALA BLERËSE**

**KLAUDJO CARI**

Klaudjo Cari